




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të diskutimit të përgjithshëm publik, mbajtur më 30.08.2019, duke filluar në orën 14:00.

Morën pjesë: Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Osman Bllaca përfaqësues i ekzekutivit.

Të pranishëm ishin edhe: Dren Shahini, banor nga Lagja e Spitalit, Qerim Ademi, kryetar i BL-së Llukar, Rrahim Isufi, banor nga lagjja "Mati 1"- Bregu i Diellit, Qemail Sekiraqa, Florie Rusinovci dhe Smail Babiqi.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, i cili tha se në këtë takim publik do të debatohet rreth dëgjimit buxhetor për vitin 2020. Për buxhetin e vitit 2020 kemi këto kategori: "paga dhe mëditje" - 34 milionë e 802,000 euro, "mallra dhe shërbime"- 19 milionë e 111,000 euro, "komunali" - 2 milionë euro, "subvencione" - 3 milionë e 780,000 euro, "investime kapitale"- 31 milionë e 885,000 euro. Buxhetin e përgjithshëm që planifikojmë ta grumbullojmë për vitin 2020, është 91 milionë 571,504 euro.

Dren Shahini, banor nga Lagjja e Spitalit, tha se ka ankesa nga qytetarët për mos praninë e Kryetarit të Komunës në këto takime publike.

Qytetarët afër rrugës " Muharrem Fejza", kërkojnë rregullimin e kësaj rruge, sepse është shumë e dëmtuar. Po ashtu, edhe rregullimin e rrugës "Jakov Xoxe" dhe të rrugës që shpie tek ambulanca.

Ai kërkoi që në atë pjesë të shihet mundësia e ndërtimit të një rrugice për nxënësit për qasje më të lehtë deri te shkolla.

Për çështjen e hapësirës së gjelbër te Fakulteti Teknik, tha se nuk do të ishte mirë që aty të ndërtohet, sepse ne qytetarët nuk kemi hapësirë tjetër të gjelbëruar për piknik.

Shqetësimi tjetër për qytetarët e asaj pjese është se aty ku është propozuar ndërtimi i Ambasadë gjermane, nuk duhet të lejohet kjo, sepse aty janë mbi 200 pisha shumë të vjetra dhe kërkojmë të mos dëmtohet ajo hapësirë.

Njëherësh kërkoi që të vihen shtylla antiparking, të bëhet shenjëzimi i rrugës për në shkollën fillore “Pavarësia”, ndriçimi i disa rrugicave dhe vendosja e “policëve të shtrirë”.

Një ankesë tjetër, që është edhe shqetësim për të gjitha lagjet e Prishtinës, është lëvizja gjithnjë e më e madhe e qenve endacakë.

Dren Kukaj, drejtor, tha se Komuna e Prishtinës është komuna më transparente në krahasim me komunat tjera. Sa i përket ndarjes së lokacionit për Ambasadën gjermane, ai lokacion është dhënë me kërkesë specifike, dhe tjetër lokacion Ambada nuk ka pranuar, përveç aty ku Kuvendi komunal ka miratuar vendimin për lokacion.

Osman Billaca tha se për investime kapitale janë paraparë 62 milionë euro, por është e vërtetë se Lagjja e Spitalit ka nevojë për shumë investime.

Lidhur me mos shpenzimin e buxhetit, problemi është se pagesat na sillen në fund të vitit, e kjo është e paraparë edhe me ligj, se ato mjete nuk mund të shpenzohen në tërësi.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se me Planin e mobilitetit parashihen edhe ndryshime në projektin e rrugës “Muharrem Fejza”, ku është kërkuar zgjerimi i saj. Po ashtu, janë paraparë edhe mjete për ndriçim. Më 5 shtator përfundon faza, në aspektin ligjor, për ndryshimin e rrethrotullimit të rruga “Muharrem Fejza”. Rruga “Jakov Xoxe” është në procedurë e sipër të prokurimit, ku ajo rrugë do të shtrohet me kubze, ndërsa rrugën për te ambulanca mbetet të shihet nëse ajo rrugë është në pronën publike, pastaj mund të fillojmë me procedurat tjera.

Mendina Braha, drejtoreshë, tha se në rrugën “Muharrem Fejza” do të vendosim shtylla antiparking, si dhe ndriçimin e disa rrugëve të tjera në këtë lagje.

Lidhur me qentë endacakë, jemi duke e punuar një projekt, ku parashihet që ata t’i strehojmë në një vend të veçantë dhe të mbeten aty.

Fatime Hajdari, drejtoreshë, tha se do t’i rregullojmë të gjitha këndet e lodrave.

Dr. Bujar Gashi, drejtor, theksoi se karrigia stomatologjike është rregulluar, ndërsa për rritjen e kapaciteteve duhet me marrë prej njësisë, nëse është e nevojshme.

Qerim Ademi kërkoi që në buxhetin e vitit të ardhshëm të parashihet vazhdimi i projekteve të cilat kanë filluar, siç janë: ndërtimi i rrugës Siqevë-Radashevc, disa rrugica në Siqevë, kanalizimi në Sharban dhe rregullimi i kanalizimit Llukar - Makovc- Grashticë. Për Drejtorinë e Shëndetësisë, paraqiti një kërkesë në emër të BL-së, që në fshatin Llukar të parashihet Shërbim i stomatologjisë.

Rrahim Isufi kërkoi që mirëmbajtja e parkut “Gërmia” të jetë në nivelin e duhur.

Njëherësh të mirëmbahen edhe lulet në ambientin e shkollës fillore “Ismail Qemali”.

Ai ngriti shqetësim rreth ndërtimit të objekteve, për të cilat tha se po jepet leja për ndërtim deri në 7 kate dhe nuk llogaritet hapësira për parking, ku si pasojë e kësaj po lindin edhe shumë ngatërresa.

Fatime Hajdari, drejtoreshë, tha se parkun “Gërmia” punëtorët e ndërmarrjes “Hortikultura” e ujin në vazhdimësi me cisterna, të gjithë pjesën e poshtme, zakonisht bëhet në mëngjes dhe në mbrëmje. Së bashku edhe me Drejtorin e Shërbimeve Publike kemi bërë përpjekje për hapjen e puseve, që furnizimi me u bërë përmes puseve, por nuk kemi hasur në ujë.

Qemal Sekiraqa kërkoi që sa më parë të bëhet rregullimi i rrugës për në Dabishevc, rrugë e cila do të lidhet me rrugën e Gllgovicës.

Gezim Mehmeti, drejtor, tha se kërkesën për rregullimin e rrugës për në Dabishevc do ta kemi parasysh dhe së shpejti këtë rrugë, me gjatësinë prej 22 km, do ta rregullojmë.

Florie Rusinovci, tha se rruga "Hasan Remniku", udhëkryqi mes rrugës "Shkëlzen Haradinaj", kur do të asfaltohet dhe kur do rregullohen kanalizimi dhe ujësjellësi. Po ashtu, kërkoi që në këtë rrugë të vendosen edhe "policë të shtrirë".

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se në lagjen "Koloviva" janë në program më se 12 rrugë për ndërtim. Gjithashtu, do të fillojmë me ndërtimin e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe të ujësjellësit në rrugë "Hasan Remniku".

Medina Braha, drejtoreshë, bëri të ditur se ka shumë kërkesa për vënien e "policëve të shtrirë" në rrugë, por vendosja e "policëve të shtrirë" në rrugë bëhet në bazë të disa rregullave të komunikacionit.

Kërkesat duhet të sillen dhe të jenë me nënshkrimet e noterizuara të banorëve të asaj lagjeje, ose të sillen nga BL-ja e asaj lagjeje.

Osman Bllaca tha se me Rregulloren e re për BL-të, për Lagjen e Spitalit janë paraparë 2 bashkësi lokale, BL nr.11 dhe BL nr.12, që hynë në kategorinë e pjesës urbane të qytetit. Të gjithë kryetarët janë pa mandat, iu ka skaduar mandati. Me rregullore të re parashihet një komision me 5 anëtarë, ku në këtë komision do të marrë pjesë edhe një përfaqësues i asaj zone.

Dren Shahini tha se është shumë e nevojshme që për secilën hyrje të ndërtesave me qenë garazhet publike, e në veçanti për biçikleta.

Ai ceku se para Radio Kosovës është një gropë në rrugë, e cila është sanuar, por prapë është krijuar gropa.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se me funksionalizimin e ndërmarrjes "Prishtina Parking", do të bëhet shënjimi dhe identifikimi i parkingjeve në komunë.

Sa i përket lejes për ndërtimin e garazheve, kompetente është Drejtoria e Urbanizmit.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se sa i përket ndërhyrjeve të cilat po bëhen në rrugë, ato bëhen nga kompanitë e ndryshme, por ato janë të detyruara që ta kthejnë rrugën në gjendjen e mëparshme. Në shumë raste ka qenë i nevojshëm edhe intervenimi i inspeksionit ndaj kompanive jo serioze, duke i sanksionuar ato për moskthimin e rrugës në gjendjen e mëparshme.

Smai Babiqi tha se është kërkesë e banorëve të këtij lokaliteti që të rregullohet rruga Glllogovicë- Dabishevc.

Gëzim Mehmeti, drejtor, theksoi se investimet në pjesën rurale janë të domosdoshme dhe të rëndësishme, por ne nuk mundemi para çdo shtëpie të shtrojmë asfalt. Për fat të keq, një pjesë e zonës së Gollakut kanë ardhur në Prishtinë, por një pjesë e konsiderueshme po ndërtojnë shtëpi vikendi në atë pjesë, që shkojnë vetëm për vikend, edhe kërkojnë t'u shtrohet asfalti deri në derë, kjo nuk është në rregull.

Debati përfundoi në orën 15:20.